
	<p><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
-----------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------

Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 79 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, dhe nenit 15 pika “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.350/03-260232/22 DT.01.12.2022, të aplikuesëve: **Ramadan, Aziz dhe Valon Azizi**, Rr.Kadri Zeka, Prishtinë, për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit 05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste –Ndërtesa “1”, “2”, “3”, “4”, “5”, “6” dhe “7”, në kuadër të bllokut urban “D4”, të tërësisë hapësinore “D” të Planit Rregullues “Kalabria” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës në procedure të rregullt administrative, me dt.20.02.2023, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË**  
**AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE”**  
**05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021**

**I. I VAZHDOHET** afati i vlefshmërisë aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” me referencë 05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021, në emër të pronarëve: **Ramadan, Aziz dhe Valon Azizi**, Rr.Kadri Zeka, Prishtinë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste - Ndërtesa 1”, “Ndërtesa 2”, “Ndërtesa 3”, “Ndërtesa 4”, “Ndërtesa 5”, “Ndërtesa 6” dhe “Ndërtesa 7”, në kuadër të bllokut urban “D4”, të tërësisë hapësinore “D” të Planit Rregullues “Kalabria” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1741-0, ZK.Çagllavicë, sipas projekt propozimit/Plani i situacionit-“zgjidhjes urbane” të prezantuar.

I. Afati i vlefshmërisë së aktit administrativ nga paragrafi I. i këtij vendimi, vazhdohet edhe për një (1) vit tjetër, dhe i njëjti do të prodhojë efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me këtë akt.

**A r s y e t i m**

Pronarët Ramadan, Aziz dhe Valon Azizi, Rr.Kadri Zeka, Prishtinë, me kërkesën 05 Nr.350/03-260232/22 DT.01.12.2022, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” me referencë 05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste, në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë.

Në kërkesë janë bashkangjitur edhe kërkesa me shkrim e aplikuesit, Vendimi i Kushteve Ndërtimore 05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 05 Nr.350/03-260232/22 DT.01.12.2022 për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” me referencë 05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste, në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria” dhe Planit Zhvillimor Urban, shqyrtimit të përmbajtjes së saj dhe konsultimit të

rregullativës ligjore në fuqi, dhe të dosjes së lëndës/kërkesës 05 Nr. 350/02–127390/21 dt. 02.07.2021 në arkivin e drejtorisë, në mënyrë procedurale dhe kronologjike konstatoi si në vijim:

Drejtorja e Urbanizmit, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”, me referencë **05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021**, i ka caktuar kushtet ndërtimore pronarëve: Ramadan, Aziz dhe Valon Azizi, Rr.Kadri Zeka, Prishtinë, ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste - Ndërtesa 1”, “Ndërtesa 2”, “Ndërtesa 3”, “Ndërtesa 4”, “Ndërtesa 5”, “Ndërtesa 6” dhe “Ndërtesa 7”, në kuadër të bllokut urban “D4”, të tërësisë hapësinore “D” të Planit Rregullues “Kalabria” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1741-0, ZK.Çagllavicë, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve. Sipas pikës “XV”, të aktit administrativ “Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”, me referencë **05 NR. 350/02-127390/21 DT. 09.10.2021**, thuhet se *“Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë”*, kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 01.12.2022 ndërsa tërheqja e Vendimit të kushteve ndërtimore nga pala është bërë me 02.12.2021, e cila është në harmoni me afatin, rrethanat dhe pikën 8 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ku thuhet se, citojmë: *“Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshtja është pranimit do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor”*;

Andaj, bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe në rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ për caktimin e kushteve ndërtimore, është i bazuar dhe ligjor, dhe kjo drejtori të njëjtit vendosi t’ia vazhdojë afatin e vlefshmërisë edhe për një (1) vit tjetër përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesit, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në dosjen e lëndës dhe në dosje të lëndës **05 Nr. 350/02–127390/21 dt. 02.07.2021** dhe **05 Nr.350/03-260232/22 DT.01.12.2022**, dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINË**  
**05 NR. 350/03-260232/22 DT. 20.02.2023**

Zyrtari,  
Anja Osmani

Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krashiqi

